## Reagim për tekstin e Profesor Vesel Latifit

Rrjeti i Grupeve të Grave të Kosovës (RrGGK), në emër të një numri aktivistesh akademikeve, dhe organizatave të shoqërise civile shpreh revoltë të thellë ndaj kapitullit "Karakteristikat e viktimave të marrëdhënies seksuale me dhunë" nga Profesor Vesel Latifi.

Sipas këtij teksti: "Viktimat e marrëdhenieve seksuale me dhunë zakonisht janë femrat që gënjehen lehtë, të pakujdesshme, mendjelehta, dhe të përdalura, rrethana të cilat sjellin me vete edhe një situatë viktimogjene (sulmin ndaj tyre)".

RrGGK përkujton Prof. Latifin dhe gjithë përkrahësit e tij që fajësimi i viktimave të dhunës seksuale është i papranueshem pasi që çon në justifikimin e këtyre veprave.

RrGGK së bashku me organizata tjera të shoqerisë civile paralajmëron masa dhe reagime të mëtutjeshme në ditët në vijim, ku do të kërkohet nga Universiteti i Prishtinës dhe MASHTI të ndërmarrin masa për modifikim drastik të këtij kapitulli.

PRESS

www.womensnetwork.org • Hajdar Dushi St. C-2 II/8, 10000 Prishtina, Kosovo • +381 (0) 38 245 850 • info@womensnetwork.org